

KOMUNIKATË PËR UEB

Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP), 2024

22.05.2025

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) për vitin 2024.

Shkalla e papunësisë në Kosovë 10,8%

Rreth dy të tretat e popullsisë në Kosovë (1 074 704) janë popullsi në moshë pune.

Persona aktivë ishin 464 567 (12 783 më pak sesa në vitin paraprak).

Persona joaktivë ishin 610 137 (84 276 më pak sesa në vitin paraprak).

Persona të punësuar ishin 414 493 (11 006 më pak sesa në vitin paraprak).

Persona të papunësuar ishin 50 074 (1 776 më pak sesa në vitin paraprak).

Indikatorët kryesorë të tregut të punës 2024 / 2023

Indikatorët kryesorë të tregut të punës (NË MIJËRA)	2024			2023		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Fuqia punëtore (persona aktivë) (15-64 vjeç)	325425	139142	464567	333019	144331	477350
Persona joaktivë (15-64 vjeç)	211849	398288	610137	243270	451143	694413
Të punësuar (15-64 vjeç)	300353	114140	414493	307509	117990	425499
Të papunësuar (15-64 vjeç)	25072	25002	50074	25510	26340	51850
Të rinj të papunë (15-24 vjeç)	6780	5377	12157	6051	4945	10996
Të rinjtë që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollimin ose trajnim (NEET)	40869	40366	81235	48369	47824	96193
Punësimi i paqëndrueshëm (15-64 vjeç)	51699	8431	60130	55570	9671	65241
Indikatorët kryesorë të tregut të punës (%)						
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore (15-64 vjeç)	60.6	25.9	43.2	57.8	24.2	40.7
Shkalla e joaktivitetit (15-64 vjeç)	39.4	74.1	56.8	42.2	75.8	59.3
Raporti punësim ndaj popullsisë (shkalla e punësimit) (15-64 vjeç)	55.9	21.2	38.6	53.4	19.8	36.3
Shkalla e papunësisë (15-64 vjeç)	7.7	18.0	10.8	7.7	18.2	10.9
Shkalla e papunësisë tek të rinjtë (15-24 vjeç)	16.7	24.7	19.5	14.4	22.8	17.3
Pjesëmarrja e të rinjve NEET në popullsinë e re (15-24 vjeç)	30.6	32.2	31.4	32.9	33.9	33.4
Pjesëmarrja e punësimit të paqëndrueshëm në punësimin e përgjithshëm (15-64 vjeç)	17.2	7.4	14.5	18.1	8.2	15.3

Përqindja e meshkujve të punësuar ishte 55,9% (2,5% më e lartë sesa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak). Kurse përqindja e femrave të punësuar ishte 21,2% (1,4% më e lartë sesa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak).

Shkalla e punësimit ishte 38,6% (2,3% më e lartë sesa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak).

Shkalla e papunësisë ishte 10,8% (0,1%) më e ulët sesa në periudhën e njëjtë të vitit paraprak).

Kurse, tek të rinjtë (15-24 vjeç), shkalla e papunësisë ishte 19,5%, ku krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak ishte më e lartë (në vitin 2023 ishte 17,3%).

Shkalla e jo-aktivitetit vazhdon të mbetet mjaft e lartë

Shkalla e jo-aktivitetit ende vazhdon të mbetet mjaft e lartë (56,8%), mirëpo vërehet një rënie e përqindjes prej 2,5%, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Shkalla e jo-aktivitetit tek femrat ishte shumë e theksuar me 74,1%, krahasuar me meshkujt (39,4%).

Tregtia, ndërtimtaria dhe arsimi prijnë me punësim

Sektorët ekonomikë që prijnë me punësim vazhdojnë të jenë: tregtia me 19,5%, ndërtimtaria me 12,6%, prodhimi me 10,6%, arsimi me 8,8% dhe administrata publike dhe mbrojtja me 8,1%, etj.

Femrat ishin të punësuar, kryesisht në sektorët e tregtisë, arsimit dhe kujdesit shëndetësor, me 53,3% të tyre. Ndërsa, meshkujt ishin kryesisht të punësuar në sektorët e tregtisë, ndërtimtarisë, prodhimit, administratës publike dhe mbrojtjes, aktivitetet e akomodimit dhe shërbimeve me 63,8%

Të punësuarit sipas gjinisë dhe aktiviteteve ekonomike, 2024, moshë 15+

Pjesëmarrja e punësimit sipas aktiviteteve (%)	Meshkuj	Femra	Gjithsej
A - Bujqësi, pylltari dhe peshkim	3.4	1.1	2.8
B - Minierat dhe xehoret	1.3	0.1	1.0
C - Prodhimi	11.6	7.9	10.6
D - Furnizimi me elektricitet, gaz, avull dhe klimatizim	2.3	0.4	1.8
E - Furnizimi me ujë, ujërat e zeza, menaxhim i mbetjeve	1.3	0.3	1.0
F - Ndërtimtari	16.9	1.0	12.6
G - Tregti me shumicë dhe pakicë, riparime automjesh dhe motoçikletash	18.7	21.7	19.5
I - Aktivitete akomodimi dhe shërbimesh ushqimi	7.9	5.6	7.3
H - Transport dhe depozitim	4.6	1.3	3.7
J - Informim dhe komunikim	3.2	2.4	3.0
K - Aktivitete financiare dhe sigurimesh	2.0	3.7	2.4
L - Aktivitete me prona të paluajtshme	0.3	0.2	0.2
M - Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	2.6	2.9	2.7
N - Aktivitete administrative dhe shërbime mbështetëse	3.6	6.2	4.3
O - Administrata publike dhe mbrojtja, sigurimi i detyrueshëm social	8.7	6.5	8.1
P - Arsimi	5.2	18.1	8.8
Q - Aktivitetet e shëndetit njerëzor dhe punës sociale	2.7	13.5	5.6
R - Arti, zbavitja dhe rekreacioni	0.9	1.2	1.0
S - Aktivitete të shërbimeve të tjera	2.0	3.9	2.5
T - Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës; aktivitete prodhuese të mallrave dhe shërbimeve të padiferencuara të ekonomive familjare për përdorim vetanak	0.1	0.2	0.1
U - Aktivitete të institucioneve dhe organizatave jashtë-territoriale	0.9	1.6	1.0
Gjithsej	100.0	100.0	100.0

Ky publikim ofron të dhëna statistikore për treguesit e tregut të punës bazuar në Anketën e Fuqisë Punëtore (AFP). Për realizimin e AFP-së në vitin 2024, metodologjia dhe standardet e aplikuara nga ana e ASK-së janë të harmonizuara me rekomandimet e Eurostat-it.

Për më shumë informata, lidhur me publikimin e Rezultateve të Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) 2024, vizitoni: <https://ask.rks-gov.net/Themes/LaborMarket>